

KONTRATË PËR SHIT-BLERJEN E AKSIONEVE

SIPAS DHE MIDIS

AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT


DHE

BLERËSIT

_____, 2000 _____

PËRMBAJTJA E LËNDËS

NENI 1 PERKUFIZIME	4
NENI 2 OBJEKTI I KONTRATËS.....	5
NENI 3 ÇMIMI I BLERJES DHE METODA E PAGESES.....	5
NENI 4 MBYLLJA	5
NENI 5 DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT	6
NENI 6 DEKLARIMET DHE GARANCITE E BLERESIT.....	9
NENI 7 DETYRIME TE TJERA TE BLERESIT.....	10
7.1. NIVELI I PUNËSIMIT DHE RITRAJNIMIT	10
7.2. INVESTIMET DHE PLANI I BIZNESIT	10
7.3. Te tjera.....	10
NENI 8 KUSHTET E MBYLLJES.....	11
8.1. KUSHTET E DETYRIMEVE TË SHITËSIT	11
8.2. KUSHTET E DETYRIMEVE TË BLERËSIT	11
8.3. PËRMBUSHJA E KUSHTEVE.....	12
NENI 9 DEMSHPERBLIMI NGA SHITESI.....	12
9.1. DETYRIMET E SHITESIT	12
9.2. EKSKLUZIVITETI DHE NDALIMI I DYZIMIT TE MJETEVE PER MBROJTJE.....	12
9.3. PERJASHTIMET DHE KUFIZIMET	13
9.4. TË DREJTAT E SHITËSIT NË LIDHJE ME HUMBJET.....	13
NENI 10 LIGJI QE DO TE ZBATOHET;ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE	14
10.1. LIGJI SUNDUES.....	14
10.2. ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE.....	14
NENI 11 TË NDRYSHME	14
11.1. AMENDIMET DHE MODIFIKIMET.....	14
11.2. NEGLIZHIMI I PËRMBUSHJES	14
11.3. NJOFTIMET.....	15
11.4. TRANSFERIMI	15
11.5. PUBLIKIMI.....	15
11.6. SHPENZIMET.....	15
11.7. EKZEMPLARËT	15
11.8. KONTRATA SI E TËRË.....	16
11.9. PALËT E TRETA	16
11.10. GARANCI TË TJERA	16
11.11. PAVLEFSHMËRIA	16
NENI 12 MONITORIMI.....	16
NENI 13 KUADRI LIGJOR.....	17
NENI 14 GJUHA E KONTRATES.....	17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË
NR. 4123 REP
NR. 572 KOL



KONTRATA PËR SHIT-BLERJEN E AKSIONEVE

Sot më datë 17.11.2000, ditën e premte, përpara meje noterit Ilir Qejvani, u paraqitën personalisht,

PALET:

Agjencia Kombëtare e Privatizimit e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, me adresë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Zj. Kozeta Fino (prej këtu e më poshte referuar si "Shtitesi")

dhe

"Rilindja" Sh.p.k., është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Shtetit Shqiptar, me seli në Korçë, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendimin Nr. 703 date 20.01.1994. Me vendimin e Asamblese së ortakeve date 16.11.2000, kjo shoqëri do të nënshkruaj këtë kontratë dhe do të përfaqësohet nga Zoti Servet Feka, (prej këtu e më poshte referuar si "Bleresi").

Palet ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së aksioneve të shoqërisë "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.a. Durres.

MEQENESE EKZISTOJNE KETO KUSHTE PARAPRAKE

- a. "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.A.Tirane (me poshte referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri aksionere shtetërore e krijuar sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.11848 Akt date 16.08.1995, me seli në Tiranë, me adresë Rruga "5 Maji". Sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr 11848/2 date 10.08.1999 kapitali aksioner i regjistruar është 339.543.000 (treqind e tridhjetë e nente milion e pesëqind e dyzet e tre mijë) leke me 339 543 (treqind e tridhjetë e nente mijë e pesëqind e dyzet e tre) aksione, me vlerë nominale të një aksioni 1000 leke.
- b. Më 25.08.2000, Shtitesi organizoi tenderin për shitjen e 76 % (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të aksioneve të "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.a. Tirane me vlerë nominale 258.053.000 (Dyqind e pesëdhjetë e tete milion e pesëdhjetë e tre mijë) leke që përfaqësojnë 258 053 aksione nga 1- 258 053 me vlerë nominale të një aksioni 1000 leke.
- c. Blerësi u përcaktua me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 490, date 19.09.2000 "Per miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve në 76% (përqind) të zotëruara nga shteti, në "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.a. Durres, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Rilindja " Sh.p.k.



- d. Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 6 tetor 1999 "Për caktimin e tenderit si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë", ndryshuar me VKM nr. 123, datë 18 Mars 2000, të Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nr. 203 Prot, date 26 prill 2000, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 490 datë 19.09.2000 "Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve prej 76 % (shtatëdhjetë e gjashtë) të zotëruara nga shteti, në "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.a. Durrës, u shpall fitues i tenderit "Rilindja" Sh.p.k.
- e. Kjo Kontratë vendos termat dhe kushtet sipas së cilave Shitësi do të shesë dhe Blerësi do të blejë **Aksionet**, subjekt i termave dhe kushteve të kësaj Kontrate.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, PALET BIEN DAKORD si më poshtë:

NENI 1 PERKUFIZIME

Perveç termave të tjera të perkufizuara diku tjetër në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalet dhe termat që vijojnë do të kenë kudo kuptimin e mëposhtem:

- a. "Kontratë" do të thotë kjo Kontratë për Blerjen e Aksioneve, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mesipërme, dhe anekset e nënshkruara dhe shkëmbyera ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;
- b. "Mbyllje" do të thotë blerja dhe shitja e Aksioneve, pagesa e plotë e Çmimit të pagueshëm në Datën e Mbylljes dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumentave dhe kryerja, përbushja e gjithë detyrimeve, respektivisht të kërkuara për tu nënshkruar dhe shkëmbyer, kryer dhe përbushur në Mbyllje në përputhje me këtë Kontratë;
- c. "Data e Mbylljes" do të thotë data në të cilën aktualisht Mbyllja do të kryhet në përputhje me dispozitatë perkatese të kësaj Kontrate, ditën e nënshkrimit të kësaj Kontrate;
- d. "Barre" do të thotë çdo shkak i ligjshëm preferimi si hipoteke, detyrim, peng, garanci, kufizim, e drejta e refuzimit të parë, e drejta e parablerjes, barre ose interesa sigurimi të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, por pa u kufizuar, transferimin e një titulli ose marrëveshje mbajtjeje) që kanë efekt të ngjashëm;
- e. "Humbje" ose "Humbjet" do të thotë çdo dem, kosto, shpenzime të kryera, humbje ose detyrime të cilat janë pasojë direkte e shkëlqes së deklaratave dhe garancive të specifikuar në nenin 5;
- f. "Pala" ose "Palet" do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç e kërkon konteksti;
- g. "Çmimi i Blerjes" do të thotë çmimi në leke, që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Aksioneve siç tregohet në nenin 3;



h. "Aksione te shitura" do te thote numri prej 1 - 258 053 (Dyqind e pesedhjetee tete mije e pesedhjetee e tre) aksione te zakonshme plotesisht te paguara, me nje vlere nominale prej 1000 leke secili, te barabarta me 76 % te aksioneve te emetuara te kapitalit te Shoqerise;

"Monitorues" do te thote institucioni i ngarkuar per ndjekjen e zbatimit dhe permbushjes nga ana e bleresit te kushteve te kontrates.

Titujt ne kete Kontrate nuk ndikojne ne interpretimin e saj.

NENI 2 OBJEKTI I KONTRATËS

Ne baze dhe subjekt te kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate, ne Daten e Mbylljes Shitesit do t'i shese Bleresit, dhe Bleresi do te bleje nga Shitesi 1- 258 053 Aksione dhe çdo te drejte qe u perket Aksioneve, te lira nga çdo Barre, per nje vlere te barabarte me shumen e percaktuar ne nenin 3;

Mbyllja e transaksionit te parashikuar ne kete Kontrate qe do te kryhet ne Daten e Mbylljes do te zhvillohet ne zyrtar e Agjencise Kombetare te Privatizimit me date 17.11.2000, ora 16.

NENI 3 ÇMIMI I BLERJES DHE METODA E PAGESES

Çmimi i blerjes per çdo aksion te shitur eshte 426.27 (katerqind e njezet e gjashte pike njezet e shtate) leke dhe Çmimi i Blerjes per Aksionet eshte leke 110.000.000 (njeqind e dhjete milion) leke.

Blerësi (RILNDJA Sh.p.k.) ka kryer likuidimin e vleres per blerjen e 76 % te paketes se aksioneve te "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.A. Durres ne vleren 110.000.000 (Njeqind e dhjete milion) leke. Kalimi i shumes ne Nr. Llogarie 4302 prane Agjencise Kombetare te Privatizimit eshte kryer me date 16.11.2000.

NENI 4 MBYLLJA

Pervec ndonje veprimi tjeter per tu ndermarre dhe te ndonje instrumenti tjeter per tu nenshkruar dhe/ose dorezuar ne perputhje me kete Kontrate, ne Mbyllje:

a) Shitesi do te:

- i. Dorëzojë Vendimin e Këshillit të Ministrave për pjesëmarrësin fitues.
- ii. Dorezoje çertifikaten qe perfaqeson Aksionet te nenshkruara rregullisht ne perputhje me legjislacionin shqiptar;
- iii. Nenshkruaje dhe dorezoje dhe/ose te beje te mundur nenshkrimin dhe dorezimin e instrumentave te tjera qe mund te jene te nevojshme sipas legjislacionin shqiptar, per ti kaluar Bleresit nje titull te mire dhe te tregtueshem per Aksionet dhe ne çdo menyre te arrije qellimin e kesaj Kontrate.
- iv. Dorëzojë miratimin për dorëheqje të anetareve te Keshillit Mbikqyres Shoqerise, nenshkruar nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit



me cilësinë e aksionerit të vetëm në datën e Mbledhjes më të afërt të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.
Aneksi "A" bashkëngjitur kësaj kontrate.

dhe

b) Bleresi do të:

- i. Paguajë të plotë Çmimin e Blerjes ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate në shumën e caktuar në nenin 3 të kësaj kontrate;
 - ii. Dorezoje vendimet e organeve drejtuese te bleresit, qe autorizojne nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj kontrate.
- Aneksi "B" bashkëngjitur kësaj kontrate.

Ne Perfundim, Blëresi do te fitoje titullin mbi Aksionet ne Daten e Mbylljes dhe do te perfitoje çdo dividend te deklaruar ose te paguar dhe do te gezoje te gjitha te drejtat e tjera qe lidhen me to duke filluar nga Data e Mbylljes.

NENI 5

DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

Shitësi i deklaron dhe i garanton Blerësit sa më poshtë;

- a. Shitësi është një institucion i organizuar sipas rregullave, i bazuar në ligjet e Shqipërisë dhe ka autoritet dhe pushtet të plotë për të drejtuar veprimtarinë e tij. Shitësi ka pushtet dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Kontrate dhe të zbatojë transaksionet e miratuara në këtë Kontrate. Shitësi ka ndërmarrë gjithë veprimet që duhen ndërmarrë, për të autorizuar zbatimin dhe dërgesën e kësaj Kontrate si dhe transaksionet e miratuara këtu. Kjo Kontrate është një Kontrate ligjore, e vlefshme dhe detyruese për Shitësin, e detyrueshme në përputhje me termat e saj.
- b. Shoqëria "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.a. është një Shoqëri e organizuar sipas rregullave, e bazuar në ligjet e Shqipërisë dhe ka autoritet dhe pushtet të plotë për të drejtuar veprimtarinë e saj siç është drejtuar deri tani dhe të zotërojë pronat dhe aktivet që ka tashmë në zotërim dhe është kualifikuar apo licencuar sipas rregullave të kryejë veprimtari në çdo juridiksion në të cilën zotërimi i pronës apo drejtimi i veprimtarisë kërkon të tillë kualifikim apo licensë. Kopje të vërteta dhe të plota të dokumentave të themelimit të Shoqërisë, me gjithë ndryshimet deri në datën e sotme, i janë vënë në dispozicion Blerësit për shqyrtim. Përveç atyre që janë miratuar në Nenin 4 të kësaj kontrate nuk do ketë më përmirësime apo ndryshime të dokumentave të themelimit para Datës së Mbylljes.
- c. Shoqëria nuk zotëron, direkt apo indirekt, asnjë aksion ose interesa të tjera kapitali të asnjë Shoqërie, korporate, ortakërie apo njësie tjetër si dhe nuk ka direkt apo indirekt kapitale ose interesa pronësie në asnjë biznes.
- d. Kapitali i regjistruar ne date 10.08.1999 i Shoqërisë është 339.543.000 leke dhe përbehet nga 1-339543 aksione, me vlerë nominale njëmijë 1000 leke për çdo aksion të zakonshëm. Gjithë aksionet e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë janë emetuar të vlefshme, plotësisht të paguara. Në Datën e Mbylljes, Blerësi do të bëhet pronari i 76 % (shtatedhete e gjashte) te Aksioneve me vlere nominale 426.27(katerqind e njezet e gjashte pike njezet e shtate) leke për çdo Aksion.





- v. dhënie kredie, parapagim apo kontribut në kapital ose investim tek një person nga ana e Shoqërisë dhe në emër të Shoqërisë;
 - vi. dhënie pagese për ndërprerje apo mbarim të marrëdhënieve të punës të asnjë punonjësi të Shoqërisë, që merr forcë ligjore nga Kontrate punësimi apo kompensimi të mbartur e të tjera të ngjashme (ose çdo amendim ndonjë nga Kontratet ekzistuese) me ndonjë punonjës të Shoqërisë, asnjë rritje në përfitimet e pagueshme ndaj çdo politike ekzistuese pagesave të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës ose Kontrateve të punësimi, si dhe asnjë rritje në kompensim, shpërblime apo të tjera përfitime për t'iu paguar punonjësve të Shoqërisë përveçse në përpjestim të drejtë me rritjet e pagave në rrjedhën normale të veprimtarisë së biznesit dhe në vazhdimësi me praktikën e kaluar;
 - vii. ndryshim në asnjë metodë të mbajtjes së llogarive apo të praktikës së kontabilitetit në lidhje me Shoqërinë, me përjashtim të ndryshimeve që kërkohen nga [IAS] [standartet e kontabilitetit];
 - viii. marrje përsipër, pranim ose garanci nga Shoqëria ose në emër të saj nga çdo palë tjetër i çdo borxhi përpara të huazuara; ose
 - ix. transaksion midis Shitësit nga njëra anë, dhe Shoqërisë nga ana tjetër përveç transaksioneve të cilat kanë hyrë në rrjedhën normale të veprimtarisë së biznesit si vazhdimësi e praktikave të paanshme të kaluara.
- i. Shoqëria ka dokumentuar rregullisht dhe vazhdimisht gjithë Taksat (përfshirë TVSH), kthimet nga pronat dhe raportet e kërkuara për t'u dokumentuar në ose para datës së Kontrates, dhe ka paguar rregullisht gjithë shumat e detyrueshme për t'u paguar prej saj në të tilla kthime dhe raporte. Shumat e treguara në të tilla kthime dhe raporte reflektojnë gjithë detyrimet tatimore të Shoqërisë për periudhat respektive kohore dhe datat e të tilla kthimeve dhe raporteve. Bilanci i Shoqërisë në 31 Dhjetor 1999 përmban provizione të mjaftueshme për detyrimet tatimore të Shoqërisë që ekzistojnë në këtë datë dhe ato provizione për detyrimet tatimore të cilat datojnë pas datës në të cilën këto Bilance janë mbajtur ose dorëzuar dhe deri në ditën e kësaj Kontrate. Shoqëria nuk ka marrë ndonjë njoftim për asnjë shumë Takse apo gjobitje dhe as nuk është në dijeni për ndonjë situatë faktike e cila mund të çojë në ndodhjen e një gjëje të tillë. Të gjithë shumat e kërkuara për t'u mbajtur apo për t'u kthyer nga punonjësit e Shoqërisë u janë paguar rregullisht autoriteteve përkatëse.
- j. Shoqëria është një pronar i vetem dhe i ligjshëm i gjithë Pronës së Patundshme. Pronesia vertetohet nga vertetimi Hipotekor leshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme rrethi Durrës, nga i cili kjo prone rezulton e rregjistruar me Nr. 08. date 25.02.2000 e lirë nga çdo hipotekë apo Barrë. As Prona e Patundshme dhe as ndonjë pjesë që buron prej kësaj nuk janë dënuar, sekuestruar apo marrë në çdo formë tjetër nga autoritetet qeveritare, dhe asnjë dënim, sekuestrim apo marrje nuk i është kërcënuar apo miratuar Shoqërisë. Gjithë ndërtesat, strukturat dhe sipërfaqet funksionale (në mënyrë të përmbledhur "Ndërtesat") përfshirë dhe pjesë të Pasurisë së Paluajtshme janë në kushte të mira dhe janë të paprekura nga defektet strukturale me rëndësi dhe janë mirëmbajtur në mënyrë të arsyeshme, subjekt i konsumit dhe prishjeve normale në përputhje me moshën e këtyre aktiveve dhe pronave. Përdorimi aktual i Pasurisë së Paluajtshme nuk po dhuron asnjë plan rregullues urbanistik apo rregulla të tjera të përdorimit të tokës.



k. Shoqëria nuk është e paaftë në përmbushjen e çdo detyrimi, Kontrate, instrumenti apo sipërmarrje në të cilat ajo është palë ose nga të cilat është e lidhur, dhe nuk ekziston asnjë detyrim, Kontrate, instrument apo sipërmarrje e tillë e cila ndikon dëmshëm apo ka prijën për të ndikuar dëmshëm në veprimtarinë e biznesit, pronave, prospekteve, operacioneve ose të kushteve (financiare apo tjetër) të veprimtarisë së biznesit.

l. Shoqëria ka siguruar licencat, lejet apo miratime të tjera të nevojshme për ta lejuar atë të vazhdojë të drejtojë veprimtarinë e saj si deri më tani dhe secila nga këto është e vlefshme dhe në fuqi. Shoqëria nuk ka arsye të besojë se asnjë nga këto licenca, leje apo miratime të tjera do t'i tërhiqen, nuk do t'i rinovohen apo do të modifikohen në atë masë që të ndikojnë në objektivin dhe qëllimet fillestare të tyre. Shoqëria ka qerë dhe është në përputhje me gjithë ligjet, rregulloret dhe termat e çdo license, leje apo miratimi, të zbatueshme për biznesin dhe aktivet e saj. Shoqëria nuk ka marrë asnjë njoftim për mospërputhje me ligjin aplikativ ose lejet përkatëse, si dhe nuk ka asnjë rrethanë, e cila pas njoftimit apo tejkalimit të afatit, ose të dyja, të mund të përbëjë mospërputhje me këtë ligj aplikativ apo leje.

m. Shoqëria zotëron ose ka të drejta ligjore dhe të vlefshme për të përdorur gjithë aktivet e përdorura apo të mbajtura për përdorim në veprimtarinë e saj, aktive këto të lira dhe të pastra nga gjithë pretendimet dhe Barrët të cilat mund të ndalojnë përdorimin e tyre për qëllimet aktualisht të përdorura në Shoqëri. Pas Shitjes çdo pretendim i regjistruar apo i zbatuar do të pranohet nga Qeveria.


n. Nuk ekziston asnjë vendim gjyqësor i formes se prere te çdo shkalle gjykimi, vendim administrativ dhe i çdo autoriteti qeveritar, qe diktojne detyrime ligjore specifike ne shoqeri .Bashkengjitur aneksi "C" i kesaj kontrate.

NENI 6

DEKLARIMET DHE GARANCITE E BLERESIT

Blerësi këtu deklaron dhe garanton Shitësin si më poshtë:

- a. Blerësi është një shoqëri e organizuar sipas rregullave të Shtetit Shqiptar dhe ekziston në mënyrë të ligjshme sipas ligjeve të juridiksionit të saj për shoqëritë.
- b. Blerësi ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Kontrate dhe të zbatojë transaksionet e miratuara nga kjo Kontrate. Asambleja e Ortakeve e Blerësit ka ndërmarrë gjithë veprimet e kërkuara prej tij për të autorizuar nënshkrimin, zbatimin dhe dërgimin e kësaj Kontrate dhe për të përmbushur transaksionet e miratuara këtu, dhe nuk është i nevojshëm asnjë veprim tjetër korporate nga ana e Blerësit për të përmbushur transaksionet e miratuara këtu. Kjo Kontrate është një Kontrate ligjore, e vlefshme dhe detyruese për Blerësin, e zbatueshme në përputhje me termat e saj. Shih Aneksin "B".
- c. Nuk kërkohet asnjë leje, miratim, autorizim, apo deklarim, i arkivuar dhe regjistruar, nga asnjë autoritet qeveritar apo rregullator, nga dhe në emër të Blerësit apo të ndonjë prej filialeve të tij, në lidhje me zbatimin, dërgimin dhe ecurimin



kësaj Kontrate nga Blerësi, apo përmbushjen nga Blerësi të transaksioneve të miratuara këtu.

Bleresi ka siguruar liçenca, leje apo miratime të tjera të nevojshme për ta lejuar atë për të vazhduar veprimtarinë dhe sejcila nga këto është e vlefshme dhe në fuqi. Blerësi deklaron se këto leje, liçenca apo miratime nuk do të tërhiqen, do të rinovohen dhe nuk do të modifikohen në atë masë që të cenojnë objektivin dhe qëllimin fillestar të tyre.

- e. Zbatim, dërgimi dhe ecuria e kësaj Kontrate nga ana e Blerësit dhe përmbushja e transaksioneve të miratuara këtu:
- i. nuk do të dhunojnë asnjë klauzolë të çdo ligji, rregulloreje, urdhëri apo gjykimi të zbatueshëm për Blerësin;
 - ii. nuk do të kërkojë asnjë leje, ose arkivim, ose njoftim të çdo autoriteti qeveritar apo rregullator sipas çdo klauzolë të ligjit në fuqi apo rregulloreje me përjashtim të çdo lejeje tashmë të arritur;
 - iii. nuk do të cenojë apo të përbëjë një shkelje të asnjë klauzole të dokumentave të themelimit të Blerësit;
 - iv. nuk do të shkele asnjë kontratë në të cilën blerësi është palë, me përjashtim të atyre lejeve dhe dokumentave të dorëheqjes të cilat tashmë janë siguruar.

NENI 7

DETYRIME TË TJERA TË BLERESIT

7.1. INVESTIMET DHE PLANI I BIZNESIT

Blerësi do të bëjë që Shoqëria të ruajë dhe të zhvillojë profilin e saj të biznesit brenda fushave të veprimtarisë të parashikuara në aktet e themelimit dhe/ose në dokumenta të tjerë të zbatueshëm organizativ.
Blerësi është i detyruar të ;

- a) zbatojë planin e tij të investimeve të pershkruar në planin e biznesit, për periudhën e 2001-2003.
- b) bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme që Shoqëria të arrijë objektivat e pershkruar në planin e biznesit; Aneksi "D" bashkëngjitur kësaj kontrate.

7.2. NIVELI I PUNËSIMIT DHE RITRAJNIMIT.

Blerësi është i detyruar të mbajë nivelin e premtuar të punësimit sipas ofertës dhe deklaratës së blerësit, e paraqitur kjo në ofertën e dhënë prej tij, ku përcaktohen plani i numrit të punonjësve dhe stafi drejtues. Shih Aneksin "D" të kësaj kontrate.

Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas kërkesës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Blerësi do të sigurojë shitesit gjithë informacionin e arsyeshëm të kërkuar nga shitesi për të monitoruar përmbushjen nga ana e Blerësit të detyrimeve burojnë nga kjo Kontratë për periudhën tre (3) vjet pas Mbylljes.



7.3. RREGJISTRIMI I AKSIONEVE

Pala blerese pas nenshkrimit, noterizimit te kesaj kontrate, eshte e detyruar te beje ndryshimin e pronesise se Aksioneve ne Zyren e Rregjistrimit Tregetar Tirane, sipas procedurave te Percaktuara ne ligjin 7638 date 19.11.1992, rregjistrimin e aksioneve ne Qendren e Rregjistrimit te Aksioneve Tirane bazuar ne ligjin 8108 date 28.03.1996 dhe rregjistrimit ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Durres brenda 30 diteve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate bazuar ne ligjin 7843 date 13.07.1994., behet pronar i 76%(shtatedhjete e gjashte perqind) te aksioneve, objekt i kesaj kontrate, ne "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Sh.a.

NENI 8 KUSHTET E MBYLLJES

8.1. KUSHTET E DETYRIMEVE TE SHITESIT


Përmbushja e detyrimeve të Shitësit në kuadrin e kësaj Kontrate në Datën e Mbylljes do të jetë subjekt i kënaqjes, në Mbyllje ose para saj, të kushteve të mëposhtme, ku Shitësi mund të heqë dorë nga një ose më shumë prej tyre në atë masë që lejon ligji:

- a. deklarimet dhe garancitë e Blerësit të përmbajtura në këtë Kontrate, do të jenë të vërteta dhe korrekte në gjithë aspektet materiale në Datën e Mbylljes dhe pas saj (dhe këto deklarime dhe garanci do të supozohen se përsëriten nga Blerësi në Datën e Mbylljes dhe pas saj), dhe Blerësi do të ketë realizuar gjithë Kontratet dhe kontratat e kërkuara për t'u realizuar nga ai para apo në Datën e Mbylljes;
- b. nuk ka asnjë veprim, padi apo procedim nga asnjë Institucion Qeveritar apo person ose njësie tjetër, që është nisur ose që kërcënon të nisët, i cili vë në pikëpyetje vlefshmërinë apo legjitimitetin e transaksioneve të miratuara këtu dhe të cilat mund të priten logjikisht të dëmtojnë nga ana materiale Shitësin në qoftë se transaksionet e miratuara përmbushen;
- c. janë siguruar të gjithë lejet, miratimet dhe heqjet dorë nga Institucionet Qeveritare dhe palët e tjera, të kërkuara në lidhje me zbatimin, dërgimin dhe ecurinë e kësaj Kontrateje nga Shitësi apo të përmbushjes nga Shitësi të transaksioneve të miratuara këtu;
- d. Blerësi do t'i ketë përmbushur gjithë detyrimet e tij të vendosura në këtë kontratë.

8.2. KUSHTET E DETYRIMEVE TE BLERËSIT

Përmbushja e detyrimeve të Blerësit në kuadrin e kësaj Kontrate në Datën e Mbylljes do të jetë subjekt i kënaqjes, në Mbyllje ose para saj, të kushteve të mëposhtme, ku Blerësi mund të heqë dorë nga një ose më shumë prej tyre në atë masë që lejon ligji:

- a. deklarimet dhe garancitë e Shitësit të përmbajtura në këtë Kontrate, do të jenë të vërteta dhe korrekte në gjithë aspektet materiale në Datën e Mbylljes dhe



pas saj (dhe këto deklarime dhe garanci do të supozohen se përsëriten nga Blerësi në Datën e Mbylljes dhe pas saj), dhe Shitësi do të ketë realizuar gjithë Kontratet dhe kontratat e kërkuara për t'u realizuar nga ai para apo në Datën e Mbylljes;

asnjë veprim, padi apo procedim nuk është nisur ose kërcënon të nisët, i cili vë në pikëpyetje vlefshmërinë apo legjitimitetin e transaksioneve të miratuara këtu dhe të cilat logjikisht mund të priten të dëmtojnë të drejtën ose aftësinë e Blerësit për të zotëruar Aksionet e Shitura pas Mbylljes, ose të dëmtojnë Blerësin apo Shoqërinë në qoftë se transaksionet e miratuara këtu përmbushen;

- c. do të sigurohen gjithë lejet, miratimet dhe heqjet dorë, nga ana e Institucioneve Qeveritare dhe palë të tjera të kërkuara në lidhje me zbatimin, dërgimin dhe ecurinë e kësaj Kontrateje nga Blerësi apo të përmbushjes nga Blerësi të transaksioneve të miratuara në këtë Kontrate;
- d. Shitësi do t'i përmbushë gjithë detyrimet e tij të vendosura në këtë kontratë.

8.3. PËRMBUSHJA E KUSHTEVE

Palët do të ndërmarrin gjithë përpjekjet e mundshme për të arritur përmbushjen e kushteve të aprovuara në PARAGRAFET 8.1 dhe 8.2 përpara Datës së Mbylljes.

NENI 9 DEMSPERBLIMI NGA SHITESI


9.1. DETYRIMET E SHITESIT

Shitesi bie dakord të ruajë Blerësin ose Shoqërinë, sikurse mund të jete rasti, të pademtuar dhe të demshperblyer, sipas kushteve dhe brenda kufijve të rena dakord me poshte, nga çdo humbje që rrjedh nga ose e lidhur me faktet ose rrethanat e ndodhura përpara Dates së Mbylljes

Çdo demshperblim për tu paguar nga Shitesi sipas kesaj Kontrate do të behet i pagueshem vetem kur Humbja perkatese siç do të vendoset nga nje Gjykate vendimet e se ciles jane te formes se prere dhe te paapelueshem ose pakundershtueshem dhe do të paguhet ne daten e cila eshte ne ose perpara 30 (tridhjetë) dite prej (i) dates ne te cilen Humbja eshte e bere e formes se prere dhe e paapelueshme dhe (ii) daten ne te cilen eshte miratuar deklarata financiare e Shoqerise, sikurse mund të jete rasti, të lidhur me vitin financiar ne te cilin eshte pesuar Humbja.

Per hir te qartesisë, asnje shkelje ose shkelje e pretenduar e çdo deklarimi ose garancie nuk i jep të drejtën Blerësit të demshperblehet ne rast se nga kjo shkelje nuk ka rezultuar ndonje Humbje e pesuar nga Shoqeria e vendosur nga Gjykata ne vendimin e saj perfundimtar.

9.2. EKSKLUZIVITETI DHE NDALIMI I DYZIMIT TE MJETEVE PER MBROJTJE



Eshte rene dakord qe e drejta per te marre demshperblim sipas kesaj klauzole perjashton çdo te drejte tjeter zhdemtimi, pretendim ose mjete mbrojtje te mundshme per Bleresin ne lidhje me shkeljen nga Shitesi te deklarimeve dhe garancive te specifikuara ne nenin 5.

Bleresi nuk do te kete te drejten e demshperblimit per Humbjet per te cilat Shoqeria ka bere provigjone specifike, ose ka vendosur reserva (specifike ose te pergjithshme) ne Llogarite, ne masen qe keto provigjone dhe reserva dhe as ne lidhje me Humbje te cilat Bleresi, ose sipas rastit Shoqeria demshperblen ne perputhje me kete Kontrate.

9.3. PERJASHTIMET DHE KUFIZIMET

Shitesi te kompesoje bleresin, ndaj çdo Humbjeje e cila eshte objekt i nje pretendimi nga Bleresi, shumen e ndonje asetit apo kredie te rastesishme qe rrjedh ose varet nga rrethanat ose veprimet e ndodhura ose te ndermarra perpara dates se kesaj Kontrate dhe qe nuk jane pasqyruar ne llogaritë.


Ne asnje rast Shitesi nuk do te jete pergjegjes ndaj Bleresit ne lidhje me ndonje shkelje te pretenduar te deklarave dhe garancive, njoftimi i te cilave i eshte dhene Shitesit pas 12 muajve nga data e kesaj Kontrate.

9.4. TË DREJTAT E SHITËSIT NË LIDHJE ME HUMBJET

Bleresi ketu bie dakord per ti njoftuar Shitesit çdo fakt qe mund te beje qe Shoqeria te pesoje nje Humbje per tu demshperblyer per te cilen Shitesi mund te konsiderohet pergjegjes, menjehere pas marrjes dijeni, dhe ne te gjitha rastet brenda 30 (tridhjete.) ditesh pas marrjes dijeni, me kusht qe ne rast se afati i fundit per te apeluar ose kundershuar kete Humbje te tille eshte me pak se 15 (pesembedhjete) dite, njoftimi do ti jepet Shitesit sipas kesaj Kontrate nga Bleresi brenda 10 (dhjete) ditesh nga momenti ne te cilin ka marre dijeni me nje njoftim me shkrim duke parashikuar me te gjithë hollesite e arsyeshme, pretendimin qe ai synon te ngreje se bashku me gjithë dokumentacionin ne dispozicion qe mund te jete i nevojshem per te mundesuar Shitesin te marre te gjitha veprimet perkatese ne lidhje me Humbjen objekt i ketij pretendimi. Per qellimin e kesaj klauzole, dijenia e Shoqerise do te konsiderohet te jete edhe dijenia e Bleresit.

Shitesi do te kete te drejten te drejtoje administrimin e rrethanave te cilat jane shkak per ngritjen e pretendimit te bere nga Bleresi dhe Bleresi bie dakord te siguroje, ne baze te kerkeses se Shitesit, qe Shoqeria do te (i) mbaje Shitesin te informuar rregullisht dhe ne kohen e duhur per çdo njoftim, komunikim ose informacion tjeter sidoqe te jete marre nga Shoqeria ne lidhje me nje pretendim te tille, (ii) bashkepunoje me Shitesin ne lidhje me zhdemtimet dhe veprimet perkatese duke i dhene Shitesit mundesi te plota per te pare te gjitha shenimet, dokumentat, dosjet dhe te dhenat e lidhura me te dhe duke i dhene mbeshtetjen e nevojshme nga punonjesit e saj, dhe (iii) te respektojte çdo udhezim te Shitesit ne drejtimin e procedimeve ligjore dhe/ose negociimet per zgjidhjen dhe/ose iniciativave te tjera ne lidhje me te.

Nese Shitesi nuk arrin te jape instruksionet menjehere pas marrjes se njoftimit perkates nga Bleresi, Bleresi pavaresisht per sa eshte parashikuar ketu, do te marre te gjitha hapat e arsyeshme duke perfshire kundershkrimin e vleresimit te taksave dhe te pretendimeve te tjera e cila mund te kerkohet per te lehtesuar shumen per te



demshperblyer sipas kesaj Kontrate dhe do ti beje te mundur Shoqerise te marre te gjitha veprimet e tilla te arsyeshme dhe do te mbaje Shitesin plotesisht dhe menjehere te informuar per çdo inisiative dhe veprim te tille.

Marrja nga Bleresi ose Shoqeria e ndonje iniciative ne lidhje me keto pretendime pa marre me pare pelqimin me shkrim te Shitesit ose mosarritjen nga Shoqeria per te zbatuar normat e parashikuara nga kjo klauzole do te rezultojne ne shkarkimin e Shitesit nga detyrimi per te demshperblyer Shitesin ne lidhje me pretendimin perkates.

Shitesi do te jete i detyruar te paguaje Bleresin ose Shoqerine sipas ketij neni, vetem nese dhe kur Shoqeria ka pesuar aktualisht Humbjet perkatese.

Pavaresisht nga ndonje kusht tjeter te kesaj klauzole, Bleresi nuk mund te ngreje ndonje pretendim kunder Shitesit per demshperblim ne masen qe nje pretendim i tille mund te ngrihet ose rritet si rezultat i ndonje ndryshimi ne legjislacionin e zbatueshem ose ne interpretimin e ndonje ligji ekzistues qe nga Data e Mbylljes.

NENI 10

LIGJI QE DO TE ZBATOHET; ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

10.1. LIGJI SUNDUES

Kjo Kontrate do të sundohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

10.2. ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Çdo polemikë apo pretendim që del në pah nga kjo Kontrate ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej këtej do t'i nënshtrohet dhe do të rregullohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane. Gjyqtaret nuk do të kenë autoritetin për të hequr, shtuar apo për të ndryshuar dispozitat e kësaj Kontrate.


NENI 11 TE NDRYSHME

10.3. AMENDIMET DHE MODIFIKIMET

Subjekt i ligjit aplikativ, kjo Kontrate mund të amendohet, ndryshohet dhe shtohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të Palëve.

10.4. NEGLIZHIMI I PËRMBUSHJES

Secila nga kërkesat apo kushtet e kësaj Kontrate - e cila mund të mos permbushet ligjërisht nga Palet per çdo lloje neglizhence, nje mospermbushje e tille mund te pretendohet ne forme te shkruar ne çdo kohe nga Pala e cila eshte e autorizuar per te marre perfitimet qe rrjedhin prej kesaj kontrate. Cdo pretendim i tille nga çdo pale do te jete me shkrim dhe i nenshkruar ne emer te saj..



11.5. NJOFTIMET

Gjithë njoftimet apo komunikimet e tjera që burojnë prej këtu, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të konsiderohen të dhëna efektivisht (i) përmes dërgimit në qoftë se dorëzohen personalisht, (ii) përmes dërgimit në qoftë se dorëzohen nga korrieri ose (iii) përmes njoftimit të marrjes në qoftë se jepen me anë të telefaksit që konfirmohet me anë të postës së regjistruar, kthe marrjen e kërkuar, në çdo rast në qoftë se është e adresuar si më poshtë:

Në qoftë se i adresohet Shitësit:

Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Tiranë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
Nr i telefaksit.: +355 42 27933
Në vëmendje të: Zj. Kozeta Fino, Drejtor

Në qoftë se i adresohet Blerësit:

Emri "Rilindja" Sh.p.k.
Adresa Fabrika e Pijeve Alkolike Korçë.
Nr i telefaksit : 08243289

11.6. TRANSFERIMI

Kjo Kontrate dhe gjithë dispozitat që burojnë prej saj duhet t'i nënshtrohen dhe të hyjnë në veprim për përfitimet e Palëve që bëjnë pjesë në këtë Kontrate dhe pasardhësve të tyre respektivë dhe transferimeve të lejuara. As kjo Kontrate as edhe ndonjë nga të drejtat, interesat apo detyrimet që rrjedhin prej kësaj nuk do të transferohen nga asnjëra Palë pa marrë më parë miratimin e shkruar të Palës tjetër, me përjashtim të rastit kur Blerësi ka të drejtë t'u transferojë të drejtat, interesat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate çdo shoqërie të përcaktuar nga Blerësi. duke siguruar, që Blerësi do të mbetet plotësisht i detyruar ndaj ecurisë së detyrimeve të Blerësit sipas kësaj Kontrate ndaj çdo shoqërie tjetër.

11.7. PUBLIKIMI

Asnjë nga Blerësit, drejtorët, nëpunësit apo të punësuarit e tij apo Shitësi nuk do të bëjë apo të nxjerrë, apo të shkaktojë bërjen apo nxjerrjen e ndonjë publikimi, lajmërimi apo deklarate të shkruar lidhur me këtë Kontrate apo transaksionet e miratuara këtu pa marrë më parë miratimin e Palëve të tjera. Kjo klauzolë nuk do të përdoret për çdo publikim, njoftim apo deklarim të shkruar që kërkohet nga ligji.

11.8. SHPENZIMET

Me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe, gjithë shpenzimet dhe kostot legale dhe kostot e tjera të kryera në lidhje me këtë Kontrate dhe transaksionet e miratuara këtu do të paguhën nga Pala që shkakton të tilla kosto dhe shpenzime. Blerësi është përgjegjës për të mbuluar të gjitha shpenzimet ligjore dhe të noterise në lidhje me rregjistrimin e kësaj shitje.



11.9. EKZEMPLARËT

Kjo Kontrate mund të ekzekutohet në mënyrë të njëkohëshme në dy apo më shumë ekzemplarë, secili prej të cilëve do të konsiderohet si original, por të tërë së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin dokument.

11.10. KONTRATA SI E TËRË

Kjo Kontrate, së bashku me të gjitha anekset shoqëruese, përbëjnë Kontraten e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me objektin e përmbajtur këtu, dhe zëvendëson gjithë marrëveshjet e mëparshme, premtimet, kontratat, rregullimet, komunikimet, deklaramet apo garancitë, gojore apo të shkruara, nga çdo nëpunës, i punësuar apo përfaqësues i çdo Pale. Me përjashtim të atyre që janë shprehimisht të shprehura më lart, gjithë kushtet, garancitë, deklaramet dhe kuptimet në lidhje me subjektin e kësaj Kontrate janë përjashtuar dhe Blerësi pohon se nuk ka hyrë në këtë Kontrate prej asnjë premtimi të bërë, deklarimi apo garancie tjetër përveç atyre të përmbajtura në dispozitat e shkruara të kësaj Kontrate, qofshin këto të shprehura apo të nënkuptuara, gojore, në formë të shkruar apo të përcjellura dhe as sekondare apo ndryshe, ku çdo lloj premtimi, deklarimi apo garancie këtu përjashtohet dhe shuhet në përputhje me, dhe e gjithë ujdia e palëve do të jetë ekskluzivisht siç është shprehur në dispozitat e shkruara të kësaj Kontrate.

11.11. PALËTE TËRETA


Asgjë nga çfarë është shkruar këtu, e shprehur apo e nënkuptuar, nuk ka patur për qëllim dhe nuk do të interpretohet me qëllim që t'i akordojnë apo t'i japin kujtdo personi apo korporate, përveç palëve dhe pasardhësve apo të ngarkuarit e tyre, asnjë të drejtë apo rregullim sipas ose për shkak të kësaj Kontrate.

11.12. GARANCI TË TJERA

Si përpara dhe pas Datës së Mbylljes, Palët do të bashkëpunojnë në mirëbesim me njëra - tjetrën dhe duhet të ndërmarrin gjithë veprimet e duhura dhe të zbatojnë çdo dokument, instrument apo tjetërsime të çdo tipi të cilat mund të jenë të nevojshme apo të këshillueshme për të zbatuar secilin nga transaksionet e miratuara këtu.

11.13. PAVLEFSHMËRIA

Në rast se një apo më shumë nga dispozitat që përmbahen në këtë Kontrate, apo në çdo instrument tjetër të cilit i referohemi këtu, do të konsiderohet, për çdo arsye, i pavlefshëm, ilegal ose i padetyrueshëm për zbatim në çdo aspekt, atëhere deri në kufirin maksimal të lejuar nga ligji, kjo pavlefshmëri, ilegalitet apo mungesë detyrimi nuk do të ndikojë ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Kontrate apo të ndonjë



instrumenti tjetër dhe Palët do të orvaten të zgjidhin me mirëkuptim ndreqjen e kësaj dispozite në një mënyrë që ajo të mos jetë e pavlefshme, ilegale apo jodetyruese.

NENI 12 MONITORIMI

1. Monitoruesi do të ushtroje kontrollin e tij për përmbushjen e detyrimeve të marra persiper nga bleresi, të specifikuar në ofertën e tij dhe të inkluduara si aneks pjesë perberese e kesaj kontrate.
2. Marrëdhëniet midis bleresit dhe monitoruesit rregullohen sipas aneksit "E" bashkelidhur kesaj kontrate.

NENI 13 KUADRI LIGJOR

Baza ligjore mbi të cilën lidhet kjo kontrate është :

- Kodi civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr.7512 date 10.08.1991
- Ligji Nr.7638 date 19.11.1992
- Ligji Nr.8334 date 23.04.1998
- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.529 date 21.08.1998
- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.463 date 06.10.1999
- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.122 date 18.03.2000
- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.123 date 18.03.2000
- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.179 date 13.04.2000
- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 490 date 19.09. 2000 për shpalljen e fituesit të tenderit.
- Udhëzimi Nr.11 date 26.09.1998 i Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.
- Urdhëri I Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit Nr.203 Prot, date 26.04.2000.
- Aktet e themelimit të shoqërisë

NENI 14 GJUHA E KONTRATES

Kjo Kontrate është përgatitur në gjuhën Shqipe, dhe përbehet nga 17 (shtatëmbëdhjetë) faqe dhe është hartuar në 5 (pese) kopje origjinal në gjuhën shqipe.

Kontrata ju lexua paleve prej meje noterit me ze të qartë dhe të kuptueshëm dhe paleve mbas deklaratimit se e gjejnë këto kontrate me vullnetin e tyre të lirë e të plotë.



nenshkruajne kontraten ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete kontrate dhe nenshkrimet e Paleve sipas ligjit.



AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT

Nga: Zj. Kozeta Fino
Titulli: Drejtor

Kozeta Fino



BLERËSI

Nga: "Rilindja" Sh.p.k. Korçë
Emri: Servet Feka
Titulli: Ortak dhe Administrator

Servet Feka
Feka



NOTER

Ilir Qejvani

Ilir Qejvani



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRE
Nr. 760 Rep. Dt. 24.03.2001
VËRTETIM
Vërtetohet se fotokopja është
e njëjtë me origjinalin - Dokumenti
E Parazit *Flomëllari*
NOTER
BASTRI MEÇAJ

Bastri Meçaj

nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorë jostrategjikë", të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti", ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.179, datë 13.4.2000 dhe nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave, si dhe të vendimit nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tenderit, si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", ndryshuar me vendimin nr.123, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 76 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Kantina e Pijeve, "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", sh.a., Durrës, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Rilindja", sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Tiranë, të lidhë kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të "Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", sh.a., Durrës, me fituesin e tenderit "Rilindja", sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM



Levit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT

DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRJEVE DHE SHOQERIVE TE VOGLA DHE TE MESME

Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL

Tel (35542) 25154
Fax (35542) 34052

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2000

URDHER
Nr 204 Date 26.4 2000.

PER

PRIVATIZIMIN ME TENDER TE PAKETES SE AKSIONEVE SHTETERORE TE SHOQERISE ANONIME KANTINA E PIJEVE GJ.K.SKENDERBEU DURRES.

Ne baze te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237 date 01.09.1997 ``Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926 date 20.04.1995 ``Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare'' ndryshuar me akte te tjera ligjore, ne mbeshtetje te Ligjit Nr.8334 date 23.4.1998 `Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike'', VKM Nr.529 date 21.8.1998 te Keshillit te Ministrave ``Per procedurat e tenderimit te paketave te aksioneve te shoqerive tregtare qe zoterohen nga shteti'' VKM Nr.122 date 18.3.2000 ``Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM Nr.529 date 21.8.1998 te Keshillit te Ministrave, VKM Nr.123 date 18.3.2000 ``Per disa ndryshime ne VKM Nr.463 date 6.10.1999 ``Per caktimin e tenderit si forme te privatizimit te paketave te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjike '' dhe VKM Nr. 179 date 13.4.2000 ``Per nje ndryshim ne VKM Nr.529 date 21.8.1998 ndryshuar me VKM Nr.122 date 18.3.2000, me cilesine e aksionerit te vetem.

Urdheroj :

- 1- Te transferohet paketa e aksioneve te shoqerise anonime Kantina e Pijeve Gj.K.Skenderbeu sh.a Durres ne masen 76% te kapitalit te regjistruar, qe I pergjigjet numrit te aksioneve nga 1 - 258.053, tek bleresi I vetem.
- 2-Forma e privatizimit do te jete tenderi I hapur dhe pagesa do te behet ne leke.
- 3- Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

M I N I S T R I
MUSTAFI MUCI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE S.M.E.-VE

URDHER
Nr 70 date 6.2 2000

PER

TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "KANTINA E
PJEVE GJ.K.SKENDERBEU" DURRES

Ne baze te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetere ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore,ligjit Nr.8334 date 23.4.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike,dhe ne zbatim te vendimit Nr.119 date 18.3.2000 te Keshillit te Ministrave "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shtetere te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjike:

Urdheroj :

- 1.Te transferohet paketa e aksioneve te punonjesve te shoqerise anonime Kantian e Pijeve Gj.K.Skenderbeu Durres, ne masen 8,294972948 % te kapitalit te regjistruar ne Gjykate,me vlere 28.165.000 leke,qe I pergjigjet numrit te aksioneve nga 1-28.165.
- 2.Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

MUSTAFA MUCI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 99 Rep.
Nr. 6 Kol.



PULLE TAKSE



KONTRATE
SHITBLERJE AKSIONESH

Sot, me date 22.01.2003, para meje noter Wimozë Popa, me seli Rr. Republikë Colloke, u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

SHITESI: Shoqeria "Rilindja" sh.p.k. Korçe, rregjistruar si person juridik me Vendimin Nr.703 date 20.01.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, perfaqesuar nga ortaket: **z. Servet Feka**, i biri i Xhevairit, i datelindjes 19 , identifikuar me pasaporten Nr.1461742, madhor me zotesi te plote per te vepruar.
z. Ylli Dersniku, i biri i Hamdiut, i datelindjes 1957, banues ne Korçe, perfaqesuar me prokuren e posaçme Nr. 134 Rep./ 108 Kol. date 18.01.2003, nga z. Servet Feka.

BLERESIT: 1- **z. Lefter Koka**, i biri i Hakiut, i datelindjes 1964, banues ne Durres, identifikuar me pasaporten Nr.0307047, madhor me zotesi te plote per te vepruar.
2- **z. Ilirjan Zhapa**, i datelindjes 11.09.1967, banues ne Tirane, identifikuar me pasaporten Nr.1594099, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje aksionesh, si me poshte vijon:

I- Shitesi, shoqeria "Rilindja" sh.p.k. Korçe, zoteron 76 % te aksioneve te shoqerise "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sh.a. Durres, aksione te cilat i ka blere nga shteti (A.K.P.) me kontraten e shitblerjes Nr.11123 Rep./ 572 Kol. date 17.11.2000 te noterit Ilir Qejvani.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË**

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme

URDHER

Nr. 417 Date 22.11.2004

**PER
PRIVATIZIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "KANTINA E PIJEVE GJ. K
SKENDERBEU" SH.A DURRES,**

Drejtuar: Agjensise Kombetare te Privatizimit, Tirane.

Ne mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutes të Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të Ligjit nr. 8885, datë 22.04.2002 "Per disa ndryshime në ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995 "Per transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, Ligjit nr. 8886, datë 22.04.2002 "Per një ndryshim në ligjin nr. 8334, datë 23.04.1998; VKM nr. 119, datë 18.03.2000 "Per procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorit jostrategjike", ndryshuar me V.K.M nr.119, datë 27.02.2003, me cilësinë e zoteruesit të 15,7% të aksioneve të Shoqërisë "Kantina e Pijeve Gj. K. Skenderbeu" Sh.a Durres,

URDHEROJ:

1. Te privatizohet paketa e aksioneve në masën 6,14 % nga paketa prej 15,7% që zoteron shteti në Shoqëri Anonime "Kantina e Pijeve Gj. K. Skenderbeu" Sh.a Durres. Numri i aksioneve të paketës që privatizohet është 20,848 aksione, me vlerë nominale 1000 leke.
2. Aksionet t'u ofrohen aksionereve të shoqërisë nëpërmjet shitjes me leke, pas përcaktimit të vlerës së tregut të kësaj pakete aksionesh me ankand, në zbatim të VKM nr. 119, datë 18.03.2000, Kap. II, Germa C, pika 1.
3. Privatizimi i aksioneve në përputhje me pikën 1 të këtij urdhëri, të përfundojë brenda afatëve ligjore në fuqi.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.



Adasias ANGJELI

MINISTER

REPUBLIKË E SHQIPËRISE
DHOMË NOTERISE TIRANË
NOTERISHTARI
BARDHA KORÇE



Nr. 1413 Kol.

Tirane, më 09/03/2005

KONTRATE SHITJE

PER SHITJEN (TRANSFERIMIN) E PAKETES SHTETERORE TE AKSIONEVE PREJ 6,14% (glashte presjekatermbedhjet%) TE

"KANTINA E PIJEVE GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU"
SH.A. DURRES

